



**V E N D I M**

*Nr. 10 Date 20.02.2009*

**PER NJE NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË  
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR 8, DATË 4.02.2009 “PER  
LIÇENSIMIN E SHOQERISE ENPOWER ALBANIA SH.P.K PËR  
KRYERJEN E AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TE ENERGJISE  
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa d, të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, dhe neneve 121 dhe 128, te Ligjit nr.8485, date 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20.02.2009, mbasi shqyrtoi kerkesen e shoqerise “ENPOWER ALBANIA” shpk, per ndryshimin e afatit te percaktuar ne Vendimin e Bordit te Komisionereve nr. 8, date 04.02.2009 “Per liçensimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike”,

**Dhe konstatoi se:**

- Me Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s Nr. 110, date 16.09.2008, shoqeria “ENPOWER ALBANIA” shpk, eshte licensuar nga ERE, per aktivitetin e Ndertimit, Prodhimit, Istalimin dhe Shfrytezimit te impanit te prodhimit te energjise elektrike me ere, per nje periudhe vlefshmerie prej 30 vjetesh.
- Ne “Rregulloren per procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit te plote /te pjesshem dhe rinovimit te licensave”, ne piken 5.2, percaktohet nje kohezgjatje e vlefshmerise se licenses se tregtimit te energjise ne perputhje me ate te licenses se prodhimit te energjise elektrike.

Per gjithë sa me sipër Bordi i Komisionereve te ERE-s,

**Vendosi:**

1. Ne vendimin nr. 8, date 04.02.2009, “Per liçensimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k, për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike”, ne piken 1, afati prej 5 vjet ndryshohet dhe behet 30 vjet.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



---

2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftoje aplikuesin per vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes ne fuqi te vendimit te Bordit te Komisionereve nr. 8, date 04.02.2009.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



---

**Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,**

**VENDIMIN**  
**Nr. 10, date 20.02.2009**

**PER NJE NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË  
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.8 DATË 4.02.2009 “PER  
LIÇENSIMIN E SHOQERISE ENPOWER ALBANIA SH.P.K PËR  
KRYERJEN E AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TE ENERGJISE  
ELEKTRIKE”**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Bujar Nepravishta</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Shkelqim Bozgo</b>	_____	_____



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Bordi i Komisionereve

---

